

**KONTRATË DHURIMI TË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË
“DAAB ENERGY GROUP” Sh.p.k**

Sot, më datën **02.09.2022** (*dymijë e njëzetë e dy*), nënshkruhet kjo Kontratë Dhurimi, mes palëve kontraktuese si më poshtë:

PALA DHURUESE:

Z. Robert BANO, atësia Kujtim, lindur në Vendreshe, Skrapar më 01-09-1972 dhe banues në Linzë, Tiranë, pallati “MGB”, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. Personal H20901230, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron **40% (dyzetë përqind)** të kuotave të kapitalit themletar të Shoqërisë “DAAB ENERGY GROUP” Sh.p.k, *më poshtë referuar si “Dhuruesi”*.

PALA PRANUESE E DHURIMIT:

Z. Fatmir Isufaj, atësia Shyqyri, lindur në Skrapar më 13-05-1975 dhe banues në Linzë, Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. Personal H50513171R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron **50% (pesëdhjetë përqind)** të kuotave të kapitalit themletar të Shoqërisë “DAAB ENERGY GROUP” Sh.p.k, *më poshtë referuar si “Pala Pranuese e Dhurimit”*.

Më poshtë referuar si veçmas “Pala” dhe së bashku “Palët”.

Të dhëna paraprake:

1. Në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është regjistruar si person juridik Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “DAAB ENERGY GROUP” Sh.p.k., me NIPT L32127008N.
2. Me Vendimin Nr. 21, datë **02.09.2022**, të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, është vendosur të realizohet dhurimi i kuotave të kapitalit themletar të Shoqërisë “DAAB ENERGY GROUP” Sh.p.k., nga ortaku Z. Robert Bano (*dhuruesi*) tek ortaku tjetër Z. Fatmir Isufaj (*pala pranuese e dhurimit*), si më poshtë:
 - Z. Robert Bano do t’i dhurojë **Z. Fatmir Isufaj** 1 (një) kuotë të barabartë me **10% (dhjetë përqind)** të kapitalit themletar që ai zotëron në Shoqërinë “Daab Energy Group” Sh.p.k.


Palët, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosën të nënshkruajnë këtë Kontratë të Dhurimit të kuotave të kapitalit themletar si vijon:

Neni 1 - Objekti i Kontratës:

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është dhurimi i kuotave të Kapitalit themletar të shoqërisë “Daab Energy Group” Sh.p.k. nga Ortaku Z. Robert Bano, tek ortaku Z. Fatmir Isufaj në cilësinë e pranueses së dhurimit.

Neni 2 - Përmbajtja e Kontratës

- 2.1 Shoqëria “Daab Energy Group” Sh.p.k është person juridik shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 27.09.2013 me Nr. NIPT-L32127008N.
- 2.2 Dhuruesi, Z. Robert Bano, është ortak i Shoqërisë “Daab Energy Group” Sh.p.k, dhe pronar i 40 % (dyzetë përqind) të Kapitalit themletar të kësaj shoqërie.
- 2.3 Pala Pranuese e Dhurimit, Z. Fatmir Isufaj, është ortak i Shoqërisë “Daab Energy Group”



Sh.p.k, dhe pronar i 50 % (pesëdhjetë përqind) të Kapitalit themeltar të kësaj shoqërie.

- 2.4 Z. Robert Bano, deklaron se i dhuron Z. Fatmir Isufaj, 1 (një) kuotë të barabartë me 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar që ai zotëron në Shoqërinë “Daab Energy Group” Sh.p.k, pa shpërblim dhe pa asnjë kusht dhe Z. Fatmir Isufaj deklaron se e pranon me mirënjohje dhurimin e kësaj kuote të barabartë me 10% të kapitalit themeltar nga Z. Robert Bano.

Neni 3 - Kalimi i pronësisë

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhuruesi humbet çdo të drejtë reale mbi 10% të kapitalit në këtë shoqëri, ndërsa pranuesi i dhurimit bëhet zotëruar i ligjshëm i kësaj përqindjeje të kapitalit themeltar të dhuruar nga dhuruesi.
- 3.2 Z. Fatmir Isufaj, me pranimin e dhurimit nga dhuruesi Z. Robert Bano, bëhet pronar në total i 1 (një) kuote, që përbën **60 % (gjashtëdhjetë përqind)** të kapitalit themeltar të Shoqërisë “Daab Energy Group” Sh.p.k;
- 3.3 Z. Robert Bano, me dhurimin e 10% të kuotave të tij tek pranuesi i dhurimit Z. Fatmir Isufaj, mbetet pronar në total i 1 (një) kuote, që përbën **30 % (tridhjetë përqind)** të kapitalit themeltar të Shoqërisë “Daab Energy Group” Sh.p.k;
- 3.4 Më nënshkrimin e kësaj kontrate pala pranuese e dhurimit merr përsipër çdo të drejtë dhe detyrim që lind nga 10 % i kuotës së dhuruar.

Neni 4 - Interpretimi i kontratës në tërësi

- 4.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë Dhurimi.

Neni 5 - Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni


- 5.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6 - Gjuha e kontratës

- 6.1 Kontrata përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

PALËT

PALA DHURUESE
Z. Robert BANO



PALA PRANUESE E DHURIMIT
Z. Fatmir ISUFAJ



* * *

VENDIM NR. 21
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k,

* * *

Sot, më datë **02.09.2022**, në orën 10:00, e thirrur rregullisht sipas normave ligjore e të statutit është mbledhur, me thirrjen e parë, pranë selisë së Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k, me NIPT L32127008N, me zyra qendrore të shoqërisë në adresën: Njësia Administrative Nr. 6 , Rr "Bedri Karapici", Zona Kadastrale 8240, Ndërtesë 1-katëshe me Nr.Pasurie 4/701, Tiranë, Shqipëri, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, për të diskutuar dhe vendosur rreth rendit të ditës në vijim:

ÇËSHTJET E RENDIT TË DITËS:

- Miratimin e dhurimit të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k nga ortaku i shoqërisë Z. Robert Bano (dhuruesi) tek ortaku tjetër i shoqërisë Z. Fatmir Isufaj (pala pranuese e dhurimit) si më poshtë:
 - **10 % (dhjetë përqind)** e kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k nga ortaku dhurues Z. Robert Bano tek ortaku Z. Fatmir Isufaj, në cilësinë e palës pranuese të dhurimit;

Të pranishëm në mbledhje, ortakët e Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k që së bashku përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë si më poshtë:

1. **Z. Fatmir Isufaj**, atësia Shyqyri, lindur në Skrapar më 13-05-1975 dhe banues në Linzë, Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. Personal H50513171R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron **50%** të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k;
2. **Z. Robert BANO**, atësia Kujtim, lindur në Vendreshe, Skrapar më 01-09-1972 dhe banues në Linzë, Tiranë, pallati "MGB", i pajisur me letërnjoftimin me Nr. Personal H20901230Ë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron **40%** të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k.
3. **Z. Altin ÇETA**, atësia Tefik, lindur në Rehovë, më 14-06-1975 dhe banues në Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. 034774538 dhe Nr. Personal H50614053V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron **5%** të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k.
4. **Znj. Vitiola LUSHNJARI**, atësia Vasil, lindur në Lushnje, më 05-08-1979 dhe banuese në Tiranë, e pajisur me letërnjoftimin me Nr. 034937224 dhe Nr. Personal H95805165S, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron **5%** të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k.



Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë me vendim unanimit;

VENDOSËN:

1. Të miratojnë dhurimin e **10% (dhjetë përqind)** të kuotave të Kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k, nga Ortaku dhurues Z. Robert Bano tek Ortaku tjetër, pranues i dhurimit, Z. Fatmir Isufaj;
2. Me nënshkrimin e Kontratës së Dhurimit të Kuotave nga palët, Z. Fatmir Isufaj bëhet pronar në total i 1 (një) kuote, që përbën **60%** të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k;
3. Ortaku Z. Robert Bano mbetet pronar i 1 (një) kuote, që përbën **30 %** të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k;
4. Ky vendim hartohet në 4 (katër) kopje në vlerë ligjore të barabartë secila. Një kopje e vendimit depozitohet pranë QKB-së.

****Lexohet, aprovohet, nënshkruhet****

*****ASAMBLEJA E ORTAKËVE*****
"DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k
ORTAKËT:

Z. Robert BANO

Z. Fatmir ISUFAJ

Z. Altin ÇETA



Znj. Vitiola LUSHNJARI